



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.60/03-32649/23
 Kaçanik, 26.12.2023

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja X (**dhjetë**) e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 26 dhjetor 2023 (E martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhamaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi-OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë Fatos Vishi – Udhëheqës i Sektorit të Sportit.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimi përshtendes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e X (dhjetë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, data 26 dhjetor, me këtë :

R E N D P U N E

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Aktivitetet rimore dhe sportive në komunën e Kaçanikut ;
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri.Në saje të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

A P R O V O J

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbali ? Procesverbal i mbledhjes se IX (nëntë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2023, u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e, **Aprovoj**

Procesverbalin e mbledhjes se IX (nëntë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2023, të datës 27.11.2023 / Lënda : 01Nr. 60/01-30428/23.

2. Aktivitetet rinore dhe sportive në komunën e Kaçanikut ;

z. Fatos Vishi : Konsideroje qe z. Fatmir Çaka, është personi më kompetent për aktivitetet rinore.

Siq i keni parë dhe ju në fillim të vitit i kemi bërë thirrjet publike me qëllim që të aplikojnë organizatat rinore dhe sportive dhe si zakonisht kanë aplikua edhe klubet sportive, organizatat rinore por edhe organizatat kulturore. Te rinia ma konkretisht kanë qenë nëse nuk gaboj organizata BONEVET dhe Këshilli i Veprimit Rinor Lokal. Theksojë që tani janë ndarë grante për të rinjët edhe nga Banka Botërore, ku përfitues të këtyre garantëve janë disa organizata rinore komunës tonë.

z.Arben Thaqi : Unë jam njohës i mirë i këtyre aktivitetave për shkak se jam vazhdimi i rrjedha të zhvillimeve të aktivitetave të tyre. Ajo që më shqetëson mua është mossuksesi i klubeve sportive të cilat edhe pse subvencionohen nuk kanë arritur rezultate të mira, përderisa kriteret të cilat edhe i kemi përmend shpeshherë si suksesi dhe masiviteti nuk janë trajtuar si kritere në ndarjen e mjeteve buxhetore për aktivitet e lartpërmendura, andaj mendojë i njëjti avaz do të vazhdojë edhe viteve në vazhdim. Ju si drejtori çfarë masa keni ndërmarrë deri tash që këto organizata ndonjëherë edhe jo të përgjegjshme të sankzionohen për shkak të ndryshimeve të kushteve të pagesave të disa klubeve sportive? A keni bërë ndonjë hulumtim, a keni vërejtur apo konstatuar se ku ngecin (qalojnë) këto mjete, arsyja se pse nuk po arrijnë rezultate, a ka ndonjë masë ndëshkuese për ato organizata. Për aktivitet rinore sidomos në fushën e kulturës, kur bëhet fjalë për një date historike, të ketë audiencë më të madhe njerëzve, të ketë një masivitet më të madh pasi qe është shqetësuese numri i pjesëmarrësive në ato aktivitete. Lidhur me grantin qe jepet nga Banka Botërore, rastësisht e kam vërejtur në rrjetet sociale dhe ne ueb faqen e komunës ku ishte cekur mosha 18 -24 vjeçar si kriter për ato projekte ndërsa unë e kam pare ne foto ku kanë qenë mbi moshën 55 vjeçare, si është e mundur me qenë përfitues një person 55 vjeçar, apo ndoshta nuk është ai por është fëmija i tyre po konkretisht mu dukur pak absurd!

z.Fatos Vishi : Ky projekt është i Bankës Botërore, 85% financohet nga Banka Botërore dhe 15 % prej komunës tonë, d.m.th. këtu është një komision i cili merret me aplikacionet që aplikojnë, por sinqerisht nuk jam në dijeni për ato foto që janë bërë, mirëpo përfaqësuesit mund me qenë të vjetër, por qe aktiviteti mundet me kanë për të rinjtë e moshës rinore 15 deri 18 vjeç. Organizator ose udhëheqës të një organizate të caktuar në rastin konkret janë bjeshkatarët ose organizata të tjera por përfituesit e projektit janë të moshës të cilën është kërkuar në projekt, për me saktë dhe më kompetent në këtë fushë është z. Fatmir Çaka.

Tek ndarja e subvacioneve të gjitha kriteret i përbahen mbas rregullores së Ministrisë së Financave, një rregulllore për të cilën edhe unë personalisht kam shumë vërejtje për shkak se ajo rregulllore nuk i parasheh disa gjera të cilat minden mu klasifikua te ndarja e subvacioneve, sidomos klubeve sportive, por ajo rregulllore është prej Qeveris e cila përdoret në gjitha komunitat e Kosovës dhe në atë rregulllore përfshihen gjitha OJQ-ët, në rastin konkret edhe klubet tona janë si OJQ, me mjetet qe ne i ndajmë si komunë për shembull me 70,000.00 euro qe i kemi pas ne vitin e kaluar dhe 85,000.00 euro qe i kem në vitin tjetër, që parqet edhe pak problem me pas sukses për klubet tona për shkak se nëse me 1,000.00 euro apo 2,000.00 euro, ja ndan një klubit edhe sukseset janë pak ma të mangëta. Në rast se edhe klubet tona nuk e shfrytëzojnë ligjin për sponsorizim që është në nivel të Kosovës, mandej është problem me pas suksese kulminante.

Shumë herë në takime kemi biseduar edhe me klubet edhe me shoqata pasi qe është interes i përgjithshëm dhe munden me shfrytëzua këtë ligj edhe me përfitua donacione. Ndoshta për faktin që edhe komuna jonë është pak më e varfér, nuk kemi shumë biznese mirëpo me subvencionet qe i ndajmë si komunë unë mendoj qe është problem me pas rezultate kulminante .

z.Ekrem Livoreka : Te ndarja e subvencioneve, a mundeni qe me rregulloret e juaja qe klubet më të suksesshme me i subvencionu dhe me ua rritë me shumë subvencionet dhe patjetër qe do të këtë sukses, duke e ditur qe disa përfitojnë dhe nuk zhvillojnë asnje aktivitet, andaj klubet qe nuk kanë aktivitete mundeni me i penalizu ndërsa klubet qe kanë aktivitete dhe sukses duhet me ua rritë subvencionet.

z.Fatos Vishi : Rregullorja si rregullore nuk e precizon që nëse një klub ose një OJQ nuk ka sukses për me penalizu aktivitetet, gjitha klubet sportive në komunën tonë d.m.th. ato qe marrin subvencione ato kanë aktivitete.

Për ndarjen e subvencioneve është një komision i cili përbehet prej dy anëtarëve nga shoqëria civile dhe tre anëtarëve të cilët janë nga organizata, nga komuna dhe prej drejtorisë. Në raportim të subvencionet është një komision që i vlerëson edhe aktivitetet, kur jemi te klubet sportive në komunën tonë duke filluar prej hendbollit, futbollit, basketbollit dhe sportet që janë kolektive janë në të njëjtin nivel garues në ligen e dytë të Kosovës, ku shumica e këtyre ekipeve me përfjashtim qe i kemi këto sportet individuale siç është i mundjes qe ka pas sukses me shumë duke pasur parasysh edhe Lorisa Reka që është shpall sportistja më e mirë në kampionatin botëror U17.

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 13:48.

Procesmbajtësja
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit për Komunitete

